



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovac

RAHOVEC / GRAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/197 Nr. i faq./Br.str./No.pg 62

Data/Datum/Date 29.02.2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja o) dhe nenit 40.2 shkronja i) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 7 paragrafi 1 dhe 2, nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, nenit 5, nenit 6 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 17/2019 për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 14/2019 për caktimin e emërtimeve dhe numërtimit të adresave për zona të qarkullimit publik ndërtesa shtëpi objekte dhe parcela kadastrale të lira, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.15 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit

1. Me këtë vendim bëhet plotësimi i listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe lista me emërtimet e reja të listës rezervë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
3. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- MAPL-së dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.197/24
Me datë:29.02.2024

